

22 dhjetor 2015, Prizren

Komunikatë për medie Komuniteti në Prizren të ketë përfshirje të shtuar në politikat e qytetit

EC Ma Ndryshe të martën ka realizuar konferencën dhe ekspozitën “Një Qytet për Komunitetin”, duke prezantuar aktivitetet e projektit “Qyteti Gjithëpërfshirës”, i cili gjatë këtij viti ka promovuar aktivizmin komunitar në lagjet urbane të Prizrenit. Në këto organizime kanë marrë pjesë përfaqësues të lagjeve urbane të qytetit, aktivistë të shoqërisë civile, zyrtarë të komunës dhe të institucioneve tjera publike.

Hajrulla Çeku nga EC Ma Ndryshe në hapje të konferencës ka theksuar se aktivitetet e realizuara në kuadër të projektit kanë pas për synim fuqizimin e aktivizmit qytetar përmes organizimit komunitar, që ka rritur presionin te institucionet për përfshirje të qytetarëve në hartimin e politikave publike, veçanërisht atyre që kanë të bëjnë me çështjet e urbanizmit dhe shërbimet publike.

Raportin vjetor të projektit e ka paraqitur Doruntina Ukimeri nga EC Ma Ndryshe duke elaboruar për takimet e zhvilluara në lagje, punëtoritë e vizionimit, zhvillimin e platformës online, performancat publike, hulumtimin mbi perceptimin e qytetarëve për çështjet e urbanizimit në Prizren, aktivizmin në raport me autoritetet, angazhimet për hartimin dhe miratimin e rregullores komunale për planifikim me pjesëmarrje, etj.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Kujtim Gashi ka pohuar se EC Ma Ndryshe duke qenë në kontakt me komunitetin ka arritur që brengat e qytetarëve t’i adresoj te organet komunale dhe institucionet tjera, dhe kështu një pjesë e tyre në formë projektesh kanë hyrë në agjendë të zbatimit nga Komuna e Prizrenit. Sipas tij përmes këtij projekti shoqëria civile është bërë urëlidhëse që afron pushtetin lokal me qytetarët dhe anasjelltas.

Rezultatet e hulumtimit në lidhje me atë se çka ka ndryshuar në urbanizmin e Prizrenit në këto tre vite i ka prezantuar Rozafa Basha, derisa Edon Mullafetahu ka dhënë udhëzime praktike mbi transformimin e hapësirave publike përmes përfshirjes së komunitetit. E banori i Qyk Mahallës, Latif Bytyqi ka shpalosur një model të mirë të organizimit komunitar në nivel të lagjes.

Në kuadër të këtij organizimi është ndarë çmimin “Lagjja më Aktive 2015”, ku në bazë të vlerësimit të bazuar në 8 kritere është zgjedhur Lagjja Bazhdarhane.

Pas përmbylljes së konferencës është hapur dhe ekspozita me fotografitë nga organizimi komunitar në Prizren për planifikimin urban me pjesëmarrje.

Me respekt,
Doruntine Ukimeri, koordinatore projekti
Prizren

Projekti "Qyteti gjithëpërfshirës – planifikimi me pjesëmarrje për zhvillim të qëndrueshëm urban në Prizren" përkrahët financiarisht nga Olof Palme International Center, që përkrahët nga Qeveria e Suedisë

